

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga gjyqtarët Valdete Daka, kryetare kolegji dhe gjyqtarëve: Agim Maliqi dhe Nesrin Lushta anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit I.H., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm P.nr.496/17 të dt.09.10.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA.1nr.1148/2017 të dt.09.01.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 16.04.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit I.H., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë -Departamenti i Përgjithshëm P.nr.496/17 të dt.09.10.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA.1nr.1148/2017 të dt.09.01.2018.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.496/17 të dt.09.10.2017, të dënuarin I.H. e ka shpallur fajtor për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së dhe e ka dënuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 23.07.2017 deri me datë 29.08.2017. I është shqiptuar

dënimi plotësues marrja e lejes së vozitjes për kategorinë “B” dhe ndalimi i marrjes së lejes së vozitjes gjatë periudhës prej 3 (tri) vite. Është obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor, në shumë prej 30 (tridhjetë) €, kurse përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës me aktgjykimin PA.1nr.1148/2017 të dt.09.01.2018, ka refuzuar si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, kurse e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit I.H., av.H.D., nga Mitrovica, për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshoj aktgjykimet e kundërshtuara dhe të marr vendim të ri duke bërë zbutjen e dënimit të shqiptuar.

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit, thekson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ka marrë për bazë zbutjen e dënimit sipas minimumit ligjor dhe nuk ka aplikuar dispozitat e nenit 75 dhe 76 të KPRK-së, siç është paraparë në rastet kur bëhet pranimi i fajësisë vullnetarisht, edhe pse i dënuari pendohet dhe shpreh keqardhje për rastin e ndodhur. Po ashtu nuk janë çmuar rrethanat tjera lehtësuese se i dënuari nuk ka qenë më parë i dënuar dhe nuk është zhvilluar procedurë tjetër ndaj tij. Gjykata e shkallës së parë si rrethanë rënduese ka marrë vetëm shpejtësinë e lëvizjes së automjetit në momentin e shkakimit të aksidentit e cila shpejtësi ka qenë 80 km/h, kurse në atë pjesë të rrugës shpejtësia ka qenë e kufizuar në 40 km/h.

Më tutje në kërkesë pretendohet se shkeljet e aktgjykimit të shkallës së parë përkitazi me lartësinë e dënimit janë përsëritur edhe në arsyetimin e aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Mendimi i Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.41/2018 dt.13.03.2018, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par. 1 lidhur me nenin 436 par. 1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit, është i pabazuar, ngase aktgjykimet kundër të cilave ka parashtruar kërkesë, nuk përmbajnë shkelje të ligjit penal.

Në këtë çështje penale, është e rëndësishme të theksohet, se i dënuari, ka bërë pranimin e fajësisë në shqyrtimin e dytë dhe si rezultat i konstatimit të gjykatës se janë përmbushur kriteret e përcaktuara në nenin 248 të KPPK-së, pranimi i fajësisë është aprovuar. Bazuar në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, rezulton se me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, janë vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe më të drejtë gjykata e shkallës së parë, ka konstatuar se pranimi i fajësisë dhe sjellja korrekte e të dënuarit paraqesin rrethana lehtësuese, kurse si rrethana rënduese ka vlerësuar shpejtësinë e drejtimit të automjetit me shpejtësi prej 80 km/h në pjesën e rrugës, ku shpejtësia ishte e kufizuar në 40 km/h, rrugë e fshatit dhe vend ku kalohet nga shumë këmbësor. Bazuar në këto karakteristika të rrugës, i dënuari nuk ia ka përshtatë shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe gjendjes në rrugë si dhe me këtë veprim ka rrezikuar pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, duke shkaktuar aksidentin.

Andaj, gjykata e shkallës së parë, përmes arsyetimit të aktgjykimit të saj, ka arsyetuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që kanë ndikuar për të përcaktuar llojin edhe lartësinë e dënimit e bindur se me anë të këtij dënimi është e pritshme të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-ës, parandalimi i kryesit nga kryerja e veprave penale

në të ardhmen dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qëllimi tjetër që t'i përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprës penale.

Gjykata Supreme e Kosovës, konstaton se konform dispozitës së nenit 385 par.5 të KPPK, kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet kur në marrjen e vendimit për dënim, dënimi alternativ, vërejtja gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, gjykata ka tejkalluar kompetencat ligjore.

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar llojin e dënimit të paraparë për këtë veprë penale gjegjësisht dënimin me burgim brenda minimumit dhe maksimumit të paraparë me ligj, kështu që pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit të paraqitura në kërkesë se aktgjykimi është përfshirë në shkelje të ligjit penal nuk është i bazuar.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË

Pml.nr.60/2018, më datë 16.04.2018

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka